L I G J
Nr. 8707, datë 24.1.2001

PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË ANONIME "SERVCOM"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Shoqëria anonime "Servcom" i nënshtrohet privatizimit.

Neni 2

Fillimi i procesit të privatizimit dhe i ristrukturimit, forma e privatizimit dhe struktura e formulës së privatizimit për shoqërinë anonime "Servcom" përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Të ardhurat që do të përfitohen nga privatizimi i "Servcom" sh.a. ndahen si vijon:

1. Punonjësve të "Servcom" sh.a. që do të dalin të papunë gjatë procesit të privatizimit dhe të ristrukturimit, u jepet një shpërblim i barabartë me pagesën e një viti dhe u paguhen kontributet e papaguara të sigurimeve shoqërore.
2. Pjesa tjetër e të ardhurave të derdhet në Buxhetin e Shtetit.

Neni 4

Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të ndjekë dhe të organizojë punën për zbatimin e këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2894, datë 9.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani